

THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË TRAJNIMIN MBI PËRGATITJEN E PROJEKTEVE PËR SHKOLLAT E MESME DHE ORGANIZATAT QYTETARE NGA MAQEDONIA E VERIUT

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, shpall thirrje për pjesëmarrje në trajnim mbi ngritjen e kapaciteteve në përgatitjen e projekteve për mobilitetin, bashkëpunim dhe aktivizim rinor në Ballkanin Perëndimor. Në këtë thirrje mund të paraqiten përfaqësuesë të shkollave të mesme dhe organizatave qytetare nga Maqedonia e Veriut. Trajnimi do të zhvillohet nga data **24 deri më 27 shtator 2019, në Hotel Skardus, Kodra e Diellit.**

QËLLIMI I TRAJNIMIT:

Trajnimi ka për qëllim që të rrisë nivelin e njohurive dhe kapacitetin e organizatave qytetare dhe shkollave të mesme, që të njëjtat në mënyrë të pavarur dhe me sukses të përgatisin propozim projekte, çdoherë duke respektuar parimin e pjesëmarrjes inkluzive të rinjve.

Në kuadër të trajnimit, pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri për arsimin ndërkulturor, pajtimin, pjesëmarrjen e të rinjve dhe përfshirjen sociale, si dhe mundësitë për kërkim të partnerëve në rajon. Pjesëmarrësit në trajnim do të fitojnë njohuri teorike dhe praktike për zhvillimin e elementeve kryesore në aplikimin e projekteve - fillimisht nga arsytimi i idesë, me vendosjen e qëllimeve dhe aktiviteteve, deri në formimin e një buxheti real dhe aktiviteteve promovuese të përpiluara dhe menduara mirë;

PËR KËND ËSHTË TRAJNIMI:

Ky trajnim është i dizajnuar për përfaqësuesit e shkollave të mesme dhe organizatave qytetare në vend, të cilat nuk kanë aspak ose kanë përvojë shumë të kufizuar në përgatitjen dhe realizimin e projekteve. Më konkretisht, kriteret për pjesëmarrje janë siç vijon:

PËRFAQËSUESIT E SHKOLLAVE TË MESME	PËRFAQËSUESIT E ORGANIZATAVE QYTETARE
→ Të cilët planifikojnë të udhëheqin procesin dhe të hartojnë një propozim projekt para institucionit të tyre	→ Të cilët planifikojnë të udhëheqin procesin dhe të hartojnë një propozim projekt para organizatave të tyre
→ Të cilët mund tërësisht t'i përkushtohen trajnimit	

→ Ata që kurrë nuk kanë qenë bartës të ndonjë projekti rajonal	
→ Deri tani nuk kanë pasur sponsorë apo partnerë të projektit të financuar nga Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor	
→	→ Të cilët nuk kanë realizuar projekte me vlerë më të lartë se 10,000 euro
→	→ Të cilët janë të regjistruara më shkurtë se 3 vjet
! RYCO inkurajon pjesëmarrjen e shkollave dhe organizatave nga komunitetet më të vogla dhe/ose multietnike	

SI TË APLIKONI PËR PJESËMARRJE:

Regjistrimi për këtë trajnim zgjat deri më 6 shtator 2019. Vetëm një person mund të aplikojë si përfaqësues i një shkolle /organizate. Aplikacionet bëhen duke plotësuar formularin: <https://bit.ly/2KNjaaR>

Përzgjedhja e pjesëmarrësve do të bëhet në bazë të kriterëve të lartpërmendura, duke respektuar barazinë gjinore dhe gjeografike. Rezultatet e përzgjedhjes do të publikohen më 9 shtator 2019 dhe kandidatet e përzgjedhur do të kontaktohen përmes telefonit ose postës elektronike.

INFORMATA SHITESË:

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) është një mekanizëm i pavarur institucional, i themeluar nga palët kontraktuese në Ballkanin Perëndimor, në mënyrë që të promovojë frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit të të rinjve. Në kuadër të punës së vetë, RYCO mbështet projekte që kontribuojnë në pajtimin në rajon përmes rritjes së mobilitetit të rinisë, bashkëpunimit dhe aktivizmit. Duke marrë parasysh këtë, që shumica e të interesuarve të kenë mundësinë për t'iu përgjigjur RYCO dhe thirrjeve të ngjashme për përgatitjen e projekteve, RYCO organizon trajnim mbi ngritjen e aftësive në këtë sferë.

Trajnimi do të zhvillohet në gjuhën maqedonase, me përkthim në gjuhën shqipe.

Të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes (udhëtimi, vendosja, ushqimi) do të mbulohen.

KONTAKT:

Për pyetje dhe sqarime shtesë, mund të kontaktoni z. Albert Hani, Koordinator i zyrës lokale RYCO për Shkup në albert.hani@rycowb.org

Shënim: Pjesëmarrja në trajnim nuk përfaqëson një garanci për alokimin e fondeve për zbatimin e projekt propozimeve nga RYCO.